



Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 29 shkurt 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për
Pranimin e Materialeve P959 dhe P960**

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Lluka Mishetiq

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të nenit 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 30 janar 2024, pasi dëgjoi parashtrimet e palëve,¹ Trupi Gjykses lëshoi urdhrin gojor për pranimin si prova të materialeve P959 dhe P960 ("Vendimi i Kundërshtuar").²
2. Më 6 shkurt 2024, Mbrojtja e z. Veseli ("Mbrojtja e Veselit") dorëzoi kërkesë për leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa").³
3. Më 19 shkurt 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") u përgjigj ndaj Kërkesës ("Përgjigjja").⁴
4. Më 22 shkurt 2024, Mbrojtja e Veselit u kundërpërgjigj ndaj Përgjigjes ("Kundërpërgjigjja").⁵

II. PARASHTRIMET

5. Mbrojtja e Veselit kërkon leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar lidhur me pikat në vijim (bashkërisht, "pikat"):

¹ Transkripti i seancës, 29 janar 2024, f. 11971-11981, 12058-12060, konfidencial.

² Transkripti i seancës, 30 janar 2024, f. 12074-12075.

³ F02104, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialeve P959 dhe P960*, 6 shkurt 2024, konfidenciale.

⁴ F02135, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialeve P959 dhe P960* (F02104), 19 shkurt 2024, konfidenciale.

⁵ F02142, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit në lidhje me Përgjigjen e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialeve P959 dhe P960*, 22 shkurt 2024, konfidenciale.

- 1) nëse Trupi Gjykses bëri gabime të shumta në arsyetim kur vendosi të pranonte materialet P959 dhe P960 nëpërmjet W04870-ës ("pika e parë"); dhe
- 2) nëse Trupi Gjykses bëri gabim ligjor kur vendosi se autorësia nuk është faktor relevant për pranueshmërinë, por për peshën që do t'u jepet këtyre materialeve në fazën e kuvendimeve ("pika e dytë").⁶

6. Mbrojtja e Veselit parashtroi se pikat përmbushin kriteret për leje për apelim sepse: (i) burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar dhe nuk janë thjesht mospajtim me të;⁷ (ii) mund të ndikojnë ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit;⁸ dhe (iii) bëjnë të nevojshme marrjen e një vendimi të menjëhershëm nga Gjykata e Apelit për të avancuar thelbësisht procesin gjyqësor.⁹ Në lidhje me pikën e parë, Mbrojtja e Veselit parashtroi se Trupi Gjykses gaboi kur i gjykoi të pranueshme materialet P959 dhe P960, sepse zbatoi në mënyrë të gabuar standardin e pranueshmërisë sipas rregullës 138(1).¹⁰ Në veçanti, sipas Mbrojtjes së Veselit, Trupi Gjykses: (i) lidhur me përmbajtjen e dokumenteve, u bazua në prova mbështetëse që i gjykoi të mjaftueshme për vërtetimin e autenticitetin *prima facie*, pa e marrë parasysh autorësinë;¹¹ dhe (ii) nuk shqyrtoi se si mungesa e provave të autorësisë ndikon jo vetëm në autenticitetin, por edhe në vlerësimin e relevancës dhe të vlerës provuese të tyre.¹² Në lidhje me pikën e dytë, Mbrojtja e Veselit parashtroi se Trupi Gjykses gaboi kur konstatoi se autorësia e materialeve P959 dhe P960 nuk është faktor i pranueshmërisë, por i peshës që do t'u jepet atyre në fund të gjykimit, pasi të shqyrtohet tërësia e provave.¹³ Mbrojtja parashtroi se ky

⁶ Kërkesa, para. 1-2, 37.

⁷ Kërkesa, para. 11-33.

⁸ Kërkesa, para. 11, 34.

⁹ Kërkesa, para. 11, 35.

¹⁰ Kërkesa, para. 12.

¹¹ Kërkesa, para. 20-25.

¹² Kërkesa, para. 28.

¹³ Kërkesa, para. 31.

konstatim, nga ana ligjore, është në kundërshtim me kriteret e rregullës 138(1) të Rregullores.¹⁴

7. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa duhet të hidhet poshtë, sepse pikat e paraqitura për leje për apelim nuk përmbushin standardin e përcaktuar në nenin 45(2) dhe rregullën 77(2).¹⁵ Në veçanti, ZPS-ja parashtrohet se Kërkesa: (i) nuk artikulon ndonjë pikë të apelueshme; (ii) interpreton gabimisht standardin e pranueshmërisë të përcaktuar në rregullën 138(1); (iii) nuk pajtohet me Vendimin e Kundërshtuar; dhe (iv) bën keqinterpretime të dukshme të Vendimit të Kundërshtuar.¹⁶ ZPS-ja parashtrohet gjithashtu se asnjëra nga pikat nuk do të ndikonte ndjeshëm në procesin gjyqësor, e as nuk do ta avanconte thelbësisht atë.¹⁷ Rrjedhimisht, ZPS-ja kërkon që Trupi Gjyqësor të hedhë poshtë Kërkesën.¹⁸

8. Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet se Përgjigjja keqkupton dhe shtrembëron thelbin e Kërkesës.¹⁹ Mbrojtja e Veselit parashtrohet se: (i) ndërhyrja e apelit nevojitet²⁰ (ii) autorësia duhet të merret parasysh kur shqyrtohet pranueshmëria, dhe rrjedhimisht relevanca, vlera provuese dhe autenticiteti i dokumenteve;²¹ (iii) Mbrojtja nuk u lejua të debatonte plotësisht këtë aspekt;²² (iv) ZPS-ja ngatërron çfarë janë dokumentet me përmbajtjen e tyre;²³ dhe (v) mungesa e provave të disponueshme lidhur me autorësinë dëmton pranueshmërinë e materialeve P959 dhe P960.²⁴

¹⁴ Kërkesa, para. 32.

¹⁵ Përgjigjja, para. 1.

¹⁶ Përgjigjja, para. 3. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 4-10.

¹⁷ Përgjigjja, para. 11-14.

¹⁸ Përgjigjja, para. 16.

¹⁹ Kundërpërgjigjja, para. 2.

²⁰ Kundërpërgjigjja, para. 3.

²¹ Kundërpërgjigjja, para. 4-5.

²² Kundërpërgjigjja, para. 6.

²³ Kundërpërgjigjja, para. 7.

²⁴ Kundërpërgjigjja, para. 8-9.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Sipas nenit 45(2) dhe rregullës 77(2), e drejta për apel lind vetëm nëse është përmbushur standardi për miratimin e lejes për apel i përcaktuar në këto dispozita. Rregulla 77(2) përcakton se:

Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.

10. Trupi Gjykues përfshin përmes referencave dispozitat ligjore përkatëse mbi standardin ligjor për miratimin e lejes për apel, të përcaktuar në vendimet e tij të mëparshme.²⁵

IV. DISKUTIM

11. Fillimisht, Trupi Gjykues vë në dukje se gjykuesit e fakteve gëzojnë kompetencë të konsiderueshme diskrecionale në marrjen e vendimit nëse një provë është e pranueshme apo jo, dhe vendimet për miratimin e lejes për apelim të pranueshmërisë duhet të jenë përjashtim absolut.²⁶ Këto parime pasqyrohen në

²⁵ F01237, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë*, 30 janar 2023, para. 7-8; KSC-BC-2020-07, F00423, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesat e ZPS-së për Leje për Apelim të Vendimit F00413 dhe Efekt Pezullues*, 8 nëntor 2021, para. 13-21; F00372, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Leje për Apelim të Urdhrit F00328*, 15 tetor 2021, para. 15-17; F00484, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit F00470*, 8 dhjetor 2021, para. 4-14. Shih gjithashtu F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel*, 11 janar 2021, para. 6-7, 9-17.

²⁶ Shih, *p.sh.*, ICTY, *Prosecutor v. Tolimir et al.*, IT-04-80-AR73.1, Appeals Chamber, [Decision on Radivoje Miletić's Interlocutory Appeal Against the Trial Chamber's Decision on Joinder of Accused](#), 27 January 2006, para. 4; *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 20 February 2001, para. 533; ICTR, *Nyiramasuhuko v. Prosecutor*, ICTR-98-42-AR73.2, Appeals Chamber, [Decision on Pauline Nyiramasuhuko's Appeal on the Admissibility of Evidence](#), 4 October 2004, para. 5; STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/T/TC/F3328, Trial Chamber, [Decision Denying 'Sabra Request for Certification to Appeal Decision Admitting Statement of PRH024 under Rule 158'](#), 15 September 2017, para. 11.

vlerësimin e Panelit të Gjykatës së Apelit se “ndërhyrja e apelit për vendimet në lidhje me pranimin e provave për ligjet vetëm në rrethana shumë të kufizuara.”²⁷ Trupi Gjykses thekson më tej se pranimi i provave materiale në këtë proces gjyqësor rregullohet kryesisht nga rregullat 137 dhe 138(1), dhe jo nga shqyrtime ose faktorë jashtë këtyre dispozitave.

12. Në kuadër të shqyrtimit të Kërkesës, Trupi Gjykses së pari vë në dukje se, në kundërshtim me argumentin e Mbrojtjes së Veselit,²⁸ Vendimin e Kundërshtuar e lëshoi pasi dëgjoi palët.²⁹ Krahës kësaj, Trupi Gjykses thekson se në Vendimin e Kundërshtuar konstatoi se materialet P959 dhe P960, të cilat i diskutoi W04870 gjatë marrjes në pyetje nga ZPS-ja, “përfshijnë lista të emrave të personave që pretendohet se u mbajtën të ndaluar nga UÇK-ja dhe informacione të tjera përkatëse, që për nga lloji dhe përmbajtja duket se konfirmojnë, ose konfirmohen nga, dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, përfshirë dëshmitë e 02161-shit dhe 04421-shit, si dhe nga prova dokumentare të tjera, përfshirë provat materiale P10, P104, P738, dhe 1D7.”³⁰ Trupi Gjykses theksoi gjithashtu se nuk po merrte vendim në lidhje me aspektin e autorësisë së materialeve P959 dhe P960, sepse kjo nuk ishte e nevojshme për vendimin mbi pranueshmërinë e tyre dhe do të shqyrtohej gjatë vlerësimit të peshës dhe vlerës provuese të tyre në fund të gjykimit, mbi bazën e tërësisë së provave.³¹ Trupi Gjykses konstatoi se materialet P959 dhe P960 janë *prima facie* relevante, autentike dhe provuese, dhe se vlera provuese e tyre nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.³²

²⁷ KSC-CA-2022-01, F00114, Gjykata e Apelit, Aktgjykimi i Apelit, 2 shkurt 2023, para. 35.

²⁸ Kundërpërgjigjja, para. 6.

²⁹ Transkripti i seancës, 29 janar 2024, f. 11971-11981, 12058-12060, konfidencial.

³⁰ Vendimi i Kundërshtuar, f. 12074.

³¹ Vendimi i Kundërshtuar, f. 12074-12075.

³² Vendimi i Kundërshtuar, f. 12075.

A. PIKA E PARË

13. Trupi Gjykses vëren se në pikën e parë të paraqitur për miratim të lejes për apelim, Mbrojtja e Veselit argumenton se “Trupi Gjykses bëri *gabime të shumta në arsyetim* kur vendosi të pranonte materialet P959 dhe P960 nëpërmjet W04870-ës”.³³ Trupi Gjykses është i mendimit se në formulimin e pikës së parë, Mbrojtja e Veselit nuk i ka identifikuar qartë gabimin ose gabimet që kërkon t’i apelojë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se pika e parë, ashtu siç është formuluar nga Mbrojtja e Veselit, nuk është konkrete, e veçantë ose e identifikueshme.³⁴ Për këto arsye, Trupi Gjykses është i mendimit se pika e parë mund të hidhet poshtë *in limine*. Megjithatë, Trupi Gjykses mban parasysh se në parashtrimet lidhur me pikën e parë,³⁵ Mbrojtja e Veselit identifikoi disa gabime që pretendohet se bëri Trupi Gjykses. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do të bëjë përjashtim dhe do t’i shqyrtojë argumentet e paraqitura nga Mbrojtja e Veselit në lidhje me pikën e parë.

14. Nga ajo që u tha më lart është e qartë se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit,³⁶ Trupi Gjykses vlerësoi kriterin e pranueshmërisë së materialeve P959 dhe P960 sikurse përcaktohet nga rregulla 138(1), dhe në të vërtetë mori parasysh parashtrimin e Mbrojtjes se mungesa e pretenduar e provave në lidhje me autorësinë ndikoi në vlerësimin sipas rregullës 138(1). Për arsyet e shtjelluara më lart,³⁷ Trupi Gjykses u bind se mungesa e pretenduar e provave lidhur me autorësinë e materialeve P959 dhe P960 nuk ndikonte në relevancën, autenticitetin dhe vlerën provuese *prima facie* të tyre, aq sa të mos lejonte pranimin e tyre. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se pika e parë shtrembëron konstatimet e Trupit Gjykses dhe është thjesht një mospajtim

³³ Kërkesa, para. 2(a) (theksimi i shtuar).

³⁴ *Shih, p.sh.*, F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel*, 11 janar 2021, para. 11. *Shih gjithashtu* ICC, Situation in the Democratic Republic of the Congo, ICC-01/04-168, [Judgment on the Prosecutor’s Application for Extraordinary Review of Pre-Trial Chamber I’s 31 March 2006 Decision Denying Leave to Appeal](#), 13 July 2006, para. 9.

³⁵ Kërkesa, para. 12-30.

³⁶ Kërkesa, para. 12, 20-25, 28. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 4-5.

³⁷ *Shih më lart* para. 12.

me to si dhe përpjekje për të debatuar edhe një herë juridikisht pranimin e materialeve P959 dhe P960. Rrjedhimisht, kriteret e tjera të standardit të lejes për apelim që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) nuk ka nevojë të trajtohen në lidhje me pikën e parë. Kërkesa për leje për apelim të pikës së parë hidhet poshtë.

B. PIKA E DYTË

15. Sikurse shtjellohet në arsyetimin në lart,³⁸ në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses konstatoi se materialet P959 dhe P960 janë të pranueshme sipas rregullës 138(1) dhe saktësoi se kur nxori këtë konstatim, atij nuk iu kërkua që të merrte vendim në lidhje me autorësinë e materialeve, sepse autorësia ka të bëjë me peshën dhe jo me pranueshmërinë e tyre, dhe Trupi Gjykses vlerëson peshën dhe vlerën provuese të secilës provë në fund të gjykimit, mbi bazën e tërësisë së provave. Trupi Gjykses gjykon se, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së në lidhje me pikën e dytë,³⁹ pyetja nëse autorësia e materialeve P959 dhe P960 ka të bëjë me peshën ose pranueshmërinë përbën temë të veçantë që buron nga Vendimi i Kundërshtuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se pika e dytë buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

16. Sa i përket ndikimit të ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit, Trupi Gjykses vë në dukje se konstatimi i tij se aspekti i autorësisë së materialeve P959 dhe P960 ndikon në peshën, dhe jo në pranueshmërinë e tyre: (i) nuk ishte i vetmi faktor që çoi në pranimin e këtyre provave materiale;⁴⁰ dhe (ii) sido që të jetë, thjesht rezultoi në pranimin e dy provave materiale, pesha provuese e të cilave do të shqyrtohet si duhet në fund të gjykimit, mbi bazën e tërësisë së provave dhe duke mbajtur parasysh mungesën e pretenduar të provave të autorësisë së tyre. Leja për apelimin e vendimeve në lidhje me pranueshmërinë e provave

³⁸ Shih më lart para. 12.

³⁹ Përgjigja, para. 3-10.

⁴⁰ Shih më lart para. 12.

përligjet vetëm në rrethana shumë të kufizuara.⁴¹ Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se Mbrojtja nuk paraqiti asnjë burim ligjor të zbatueshëm para këtij Trupi Gjykses që do të kërkonte nga ai të merrte vendim në lidhje me aspektin e autorësisë si kusht për pranimin e materialeve P959 dhe P960. Mbrojtja e Veselit as nuk ka vërtetuar se po të ishte marrë vendim në lidhje me aspektin e autorësisë, ai vendim do të kishte qenë ndryshe.

17. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Veselit nuk ka vërtetuar se si pika e dytë do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit. Rrjedhimisht, kriteret e tjera të standardit të lejes për apelim që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) nuk ka nevojë të trajtohen në lidhje me pikën e dytë. Kërkesa për leje për apelim të pikës së dytë hidhet poshtë.

V. KLASIFIKIMI

18. Trupi Gjykses vë në dukje se Kërkesa dhe Kundërpërgjigjja u dorëzuan si konfidenciale dhe se deri tani nuk janë dorëzuar versionet e redaktuara publike të tyre. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen që deri të premten, 8 mars 2024, të dorëzojë versionet e redaktuara publike të Kërkesës dhe Kundërpërgjigjes, ose të kërkojë riklasifikimin e tyre si publike. Për parashtrimet e ardhshme, Trupi Gjykses i kujton Mbrojtjes urdhrin gojor të tij në lidhje me parimin e procesit publik, me të cilin Trupi Gjykses urdhëroi palët dhe pjesëmarrësit, që si parim: (i) të dorëzojnë njëkohësisht edhe versionin e redaktuar publik të parashtrimit konfidencial; dhe (ii) kur ka arsye bindëse për të mos e bërë këtë, në pjesën për klasifikimin e parashtrimit të bëjnë të ditura arsyet pse versioni i redaktuar publik nuk mund të dorëzohet njëkohësisht.⁴²

⁴¹ Shih më lart para. 11.

⁴² Transkripti i seancës, 7 nëntor 2023, f. 9446, rreshtat 13-20. Shih gjithashtu F02067, Trupi Gjykses, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit F01963, 19 janar 2024, para. 37.

19. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se ZPS-ja nuk kundërshton riklasifikimin e Përgjigjes si publike.⁴³ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses udhëzon Zyrën Administrative të riklasifikojë Përgjigjen si publike.

VI. VENDIM

20. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- (a) **HEDH POSHTË** Kërkesën;
- (b) **URDHËRON** Mbrojtjen e Veselit të dorëzojë versionet e redaktuara publike të Kërkesës dhe Kundërpërgjigjes, ose të kërkojë riklasifikimin e tyre, deri të **premtën, 8 mars 2024**; dhe
- (c) **UDHËZON** Zyrën Administrative të riklasifikojë Përgjigjen si publike.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E enjte, 29 shkurt 2024

Në Hagë, Holandë.

⁴³ Përgjigja, para. 15.